

=====

Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e drejtimit të studimeve universitare
Rast studimi: Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë

Merita Begolli Dauti

University "Haxhi Zeka", Kosovo, merita_dauti@hotmail.com

=====

Factors that influence in selection of direction for university studies
Case study: University "Haxhi Zeka" - Peja

Merita Begolli Dauti

University "Haxhi Zeka", Kosovo, merita_dauti@hotmail.com

Abstract

Everyday tourism is spreading with great importance in Kosovo especially during last years, not only as a major possibility for employment but also as a possibility to build an image of a newest state in Europe which corresponds with many specific characteristics and available unique values. Therefore the importance of tourism, review and analysing of all factors that lead to its development and in more rational use of natural, human and financial resources respecting cultural values as well as the spirit and country traditions where tourism is developed should become priority for whole society in general. Development and its quality are not possible without human resource. Main factors of success in tourism are human resources which through high education attain perfection and get qualified in industry of tourism and hospitality. In conditions of new economy, the economy based in knowledge, the human capital within compassion in population of Kosovo is the most important asset of the country. This study has to do with education of staff in the field of tourism and hospitality as well as factors that influence in selection of direction for university studies and how much are students content with this direction in general aspect. This cooperation between high education (faculty) and employment market is important especially in the process of standard development and new learning projects, in guaranteeing of needed conditions for practical training, in practice qualifying of staff, in determining of necessary specialists for employment market. The study is based at the empiric data extracted through questionnaires' in which were

=====

surveyed students of University "Haxhi Zeka"- in Peja, respectively Faculty:Managing, Tourism, hospitality and Environment. The aim of this study is to provide empiric proves regarding factors that influence in selection of direction for university studies and how much are students content with this direction in general aspect. Data are collected in surveying 102 students using questionaries' with closed questions and on Likerts scale.

Keywords: Tourism, higher education, study program, motivation, economy.

JEL Classification: I2, I23, M1, M12, M5, M53

Abstrakt

Turizmi çdo ditë po merr përmasa me rëndësi më të madhe në Kosovë, sidomos gjatë viteve të fundit, jo vetëm si një mundësi e madhe për punësim, por edhe si një mundësi për të ndërtuar një imazh të shtetit të ri në Evropë, i cili korrespondon më shumë me karakteristika specifike dhe vlerat unike në disponim. Kështu që rëndësia e turizmit, shqyrtimi dhe analiza e të gjithë faktorëve që shpjen në zhvillimin e tij dhe në shfrytëzimin sa më racional të resurseve natyrore, njerëzore dhe financiare duke respektuar vlerat kulturore si dhe shpirtin dhe traditat e vendit ku zhvillohet turizmi duhet të bëhet prioritet për tërë shoqërinë në përgjithësi. Faktorët kryesor të suksesit në turizëm janë burimet njerëzore, të cilët nëpërmes shkollimit të lartë perfeksionohen dhe kualifikohen në industrinë e turizmit dhe hotelierisë. Në kushtet e ekonomisë së re, ekonomisë së bazuar në dituri, kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë e Kosovës është aseti ekonomik më i rëndësishëm i vendit. Ky punim ka të bëjë më edukimin e kuadrove në fushën e turizmit dhe hotelierisë, si dhe faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e drejtimit të studimeve universitare dhe sa janë studentët të kënaqur më këtë drejtim në aspektin e përgjithshëm. Ky bashkëpunim në mes të arsimit të lartë (fakultetit) dhe tregut të punës është i rëndësishëm veçanërisht në procesin e zhvillimit të standardeve dhe programeve të reja mësimore, në garantimin e kushteve të duhura për trajnimin praktik, në aftësimin praktik të kuadrove, në përcaktimin e specialistëve të nevojshëm për tregun e punës. Qëllimi i këtij punimi është që të sigurojë prova empirike në lidhje me faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e drejtimit të studimeve universitare dhe sa janë studentët të kënaqur më këtë drejtim në aspektin e përgjithshëm. Të dhënat janë mbledhur me anketimin e 102 studentëve, duke përdorur pyetësor më pyetje të mbyllura dhe më shkallë të likertit.

Fjalët kyçe: turizem, edukimi I lartë, programet e studimit, motivimi, ekonomia

Klasifikimi JEL: I2, I23, M1, M12, M5, M53

Hyrje

Sistemi arsimor në Kosovë është reformuar në vitet e fundit duke u

=====

përqendruar në kualitetin e arsimit. Kosova po krijon parakushte themelore për zhvillimin e një shoqërie të bazuar në dituri dhe të fuqizuar nga një popullate e re. Aktualisht, sektori i arsimit në Republikën e Kosovës karakterizohet nga përpjekje intensive reformuese në të gjithë nënsektorët që kanë për qëllim të trajtojnë sfidat kryesore të rritjes së pjesëmarrjes dhe të përmirësimit të barazisë e cilësisë së arsimit në kushte të mjetëve të kufizuara në dispozicion. Përkundër përparimit të mirë në reformat arsimore, mbesin edhe shumë sfida që duhen përballur (PSAK, 2011-2016). Si synim global dhe themelor i zhvillimit të turizmit në Kosovë në periudhë e pas luftës, është theksuar zhvillim i shpejtuar shoqëror ekonomik i Kosovës në aktivizimin e resurseve ekzistuese mjaftë të rëndësishme turistike, të cilat ndikojnë në rritjen e të hyrave në Kosovë, ku komponentë e veçantë është punësimi dhe rëndësia e prodhimit, sidomos në ato komuna të Kosovës që kane resurse turistike. Duke nisur nga punësimi i gjeneratave të reja ekzistojnë programe mësimore të arsimit të lartë, ku nëpërmes këtyre programeve përgatiten e kuadrove të specializuara për kryerjen e punëve të turizmit dhe hotelierisë, konform nevojave të tregut të punës së Kosovës, si dhe përgatitjen studentët për pozita të larta menaxheriale, me aftësi, shkathtësi dhe kompetenca përkatëse. Në kushtet e ekonomisë së re, ekonomisë së bazuar në dituri, kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë e Kosovës është aset ekonomik më i rëndësishëm i vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit arsimor Kosovës në ofrimin e shkathtësive kyçe që kërkohen në tregun e punës do të jetë i një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Përmirësimi i standardeve të arsimit stimulon zhvillimin ekonomik në mënyrë direkte nëpërmjet efektit të tij në produktivitetin e punëtorëve. Për më tepër forca punëtore e arsimuar është më fleksibile dhe e adaptueshme dhe si rrjedhim i përgjigjet më mirë nevojave në ndryshim e sipër të ekonomisë Kosovare dhe Evropiane (Hot i& Adnett, 2004). Në përputhje me zhvillimet e tanishme ekonomike dhe shoqërore, autoritetet janë të ndërgjegjshme për rëndësinë e zgjerimit të arsimit të lartë, nevojën për përkrahjen e shkathtësive teknike dhe profesionale dhe rëndësinë e arsimit të lartë si mjet për trajtimin e qëllimeve parësore të zhvillimit ekonomik.

Qëllimi i punimit

Qëllimi i hulumtimit është *së pari*, të nxjerrë në pah rëndësinë e burimeve njerëzore si një forcë punëtore e arsimuar, fleksibile dhe e adaptueshme që i përgjigjet nevojave në ndryshimin e sipër të ekonomisë jo vetëm kosovare por edhe më gjerë. *Së dyti*, të analizojë që investimet në një kohë në arsimimin në burime njerëzore është një reflektim i një investimi në të ardhmen. *Së treti*, bashkëpunimi në mes të arsimit të lartë dhe tregut të punës është i rëndësishëm veçanërisht në procesin e zhvillimit të standardeve dhe programeve të reja mësimore, në

garantimin e kushteve të duhura për trajnimin praktik, në aftësimin praktik të kuadrove, në përcaktimin e specialistëve të nevojshëm për tregun e punës. Së katërti, edukimi i kuadrove të reja në fushën e turizmit dhe hotelerisë, është i përqendruar kryesisht në realizimin e objektivave të tregut të punës, por është e pamundur për të arritur efikasitetin dhe efektivitetin e studentëve, pa marrë parasysh interesat e tyre.

Qëllimi i studimit është shprehur përmes këtyre objektivave :

- Për të rishikuar literaturën për edukimin e burime njerëzore si një bazë e cila shërben në identifikimin e modelit të hulumtimit.
- Kryerja e një pyetësoi për të evidentuar se çfarë problemesh kanë në zgjedhjen e drejtimit të studimeve universitare dhe sa janë studentët të kënaqur më këtë drejtim në aspektin e përgjithshëm
- Kryerja e një analize të dhënash bazuar në informacionin cilësor dhe statistikor duke kombinuar metodat e analizës statistikore dhe asaj cilësore.
- Paraqitja e një sërë përfundimesh të punimit, duke dhënë disa shpjegime profesionale për çështjet e bëra objekt studimi në këtë punim.

3. Hipoteza

Duke pasur parasysh se edukimi i kuadrove të reja në arsimin e lartë janë pasuria më e madhe e një vendi. Gjithë punimi dhe çështjet e kërkimit të evidentuara dhe të shtjelluara tek paraqitja e rezultateve dhe diskutimi i tyre, orientohen dhe burojnë nga hipoteza:

Pyetja kërkimore: A janë studentët e motivuar dhe të kënaqur për studimet e tyre në fushën e turizmit dhe të hotelerisë?

Hipoteza: "Studentët janë të motivuar dhe të kënaqur për studimet e tyre në fushën e turizmit dhe të hotelerisë"

4. Rëndësia e hulumtimit

Hulumtimi i kësaj problematike, është i rëndësishëm për të mbuluar dhe për të shpjeguar rëndësinë e regjistrimit të brezave të reja në studime themelore, si dhe për ti identifikuar efektet pozitive dhe negative të këtyre të këtyre studimeve. Kontributi më i madh në shqyrtimin e regjistrimit më vetë dëshirë do të jetë i suksesshëm në largimin e të gjithë faktorëve që ndikojnë negativisht në arritjen e sukseseve të mëtutjeshme ku këto suksese do të mundësojë efikasitet më të madh në kuadër të studimeve si dhe reflektim me rezultate të mira. Rëndësia e këtij studimit mendoj që është e madhe sepse në radhë të parë u vjen në ndihmë gjeneratave të reja në mënyrë të përgjithshme .Për këtë arsye, arsimimi i kuadrove të reja është thelbësor në shumë mënyra. Ai rrit produktivitetin ndërkohë që studentët janë të "pajisur" me njohuri profesionale, eksperiencë dhe ide të vlefshme.

5. Metodologjia

Për realizimin e këtij studimi është përdorur një metodologji që konsiston në të dhëna primare. Për të parë se sa janë të kënaqur më përzgjedhjen e këtij drejtimi dhe ecuritë tjera në studime, kamë hartuar një pyetësorë. Pyetësorët janë më pyetje të mbyllura dhe më shkallë të likertit . Formimi i një pyetësori për ti anketuar studentët në Fakultetin “Menaxhment, Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis ” për të evidentuar se çfarë mendojnë ata në lidhje më studimin e tyre. Ky pyetësorë është drejtuar studentëve në këtë fakultet .Pyetësorët u janë shpërndarë 110 studentëve, ndërsa 102 kanë dhënë përgjigje. Shpërndarja e pyetësorëve është bërë personalisht duke i anketuar studentët. Kryerja e një analize të dhënash bazuar në informacionin cilësor dhe statistikor duke kombinuar metodat e analizës statistikore dhe asaj cilësore dhe përpunimin e tyre më softverin SPSS (*Statistical Package for the Social Sciences*). Paraqitja e një sërë përfundimesh të punimit, duke dhënë disa shpjegime për çështjet e bëra objekt studimi në këtë punim.

6. Arsyeja për të studiuar në arsimin e lartë

Arsyeja kryesore për të studiuar është motivimi i studentëve për të ndjekur arsimin e lartë i cili është rritur me një lidhje të madhe në mes të procesit të të mësuarit dhe aplikimin e perceptuar për nevojat e nxënësit (Knowles, 1990). Prandaj motivimi do të jetë i një rëndësie të madhe në vendimin e nxënësve për të ndjekur arsimin e lartë. Ndryshimet e shpejta në tregun e punës kanë vënë theks të madh në nxitjen e të mësuarit duke pasur në konsideratë vende të reja pune të krijuara së bashku për ti përmbushur nevojat e një ekonomie globale. Për shkak të këtij mjedisi të shpejtë në ndryshim, të mësuarit do të ketë një rëndësi të madhe në të ardhmen (Cross, 1981). Sipas autores Heelan (2001), kërkesa për shumë punëtorë të trajnuar vazhdon të rritet, punëtorët do të duhet të kenë arsimit të lartë, nëse ata dëshirojnë të mbetet konkurruese në vendin e punës. Këta faktorë do të detyrojnë të gjithë, por sidomos të rriturit në arritjen e arsimit të lartë, nëse ata dëshirojnë të mbijetojnë dhe të avancohen në vendin e punës (Aslanian & Brickell, 1980). Hulumtimet e fundit kanë treguar se zënia e vendeve të punës apo avancimi në punë është e vetme arsyeja më e rëndësishme për të ndjekur arsimin e lartë. Për shkak se për shumicën e të rriturve është pikë motivuese dhe thelbësore ndjekjen e arsimit të lartë, ku rëndësia e saj nuk mund të neglizhohet (Henry & Basile, 1994). Faktorët tjerë që mund të motivojnë njerëzit për të ndjekur arsimin e lartë përfshijnë, rritjen e të ardhurave, siguria e punës, përmirësimin e kushteve të punës, dhe kohën e përmbushjes për të dalë në pension. Ndërsa sipas Malcolm Shepherd Knowles (1913–1997) edukimi për studentët e rritur është parë si një proces i cili duhet të jetë në përputhje me karakteristikat dhe fazat jetësore nëpër të cilat studentët janë duke kaluar. Në këtë grup të karakteristikave më ndikim në procesin e të nxënës

=====

konsiderohet të luajnë rol të veçantë mosha, faza e zhvillimit, aftësitë inteligjente, aftësitë për të marrë vendime dhe aftësitë e studentëve për të gjykuar drejt. Ndërsa, në raport me fazën e jetës, ndikim në edukimin dhe nivelin e performimit të tyre konsiderohet të luajnë rol edhe martesë, puna, dhe faktorë të tjerë të ndikuar nga kultura ose mosha specifike e studentëve. Ndërkaq, në grupin e karakteristikave të ndërlidhura me situatat, rol të veçantë në performancën e studentëve llogaritet të kenë lloji i angazhimit në sistemin e arsimit, vendbanimi, programet ditore të tyre, dhe karakteristikat e tjera personale si mënyra se si ata realizojnë të nxënës ose i menaxhojnë obligimet e tyre (Cross, 1991). Gjithashtu, të nxënës konsiderohet si proces aktiv në të cilin studentët ndërtojnë ide të reja ose koncepte duke u bazuar në njohuritë e tyre aktuale dhe paraprake. Studentët selektojnë dhe transferojnë informatat duke ndërtuar hipoteza dhe marrin vendime duke u bazuar në strukturën kognitive përmes skemave dhe modeleve mendore, të cilat u ndihmojnë atyre të organizojnë përvojat dhe u mundësojnë të shkojnë përtej informatës e cila i është dhënë (po aty, fq. 21).

7. Motivimi dhe disa nga vështrimet e përgjithshme

Gjatë dekadës së fundit janë miratuar akte të shumta ligjore e nënligjore, janë ndërtuar shumë shkolla dhe janë themeluar institucione të shumta të reja. Ka pasur përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e kurrikulave dhe për hartimin e sigurimit të teksteve të reja shkollore, të cilat tash duhet të mbështeten nga praktika të reja të mësimdhënies e të nxënies. Motivimi njerëzor ka qenë në qendër të studimeve në shumë disiplina, duke përfshirë edukimin, psikologjinë, sociologjinë, shkencat politike dhe ekonominë. Kjo ndodh sepse njerëzit angazhohen vazhdimisht në sjellje të qëllimshme dhe prapa këtyre sjelljeve janë motivet. Autori Keller (1983) e përcakton motivimin si “madhësia dhe drejtimi i sjelljes”. Akoma më tej, ai vazhdon se përpjekja për të bërë diçka është indikator kryesor i motivimit. Nga ana tjetër, autori Song (2000), përcakton tre tipe të motivimit, motivimi për të nisur diçka, motivimi për të insistuar dhe motivimi për të vazhduar. Nga ana tjetër, prania e motivimit mund të dalë në pah nga disa indikatorë sjellorë të tillë si zgjedhja e detyrës, përpjekja, insistimi dhe arritjet (Pintrich & Schunk, 1996). Në këtë këndvështrim, një rëndësi shumë e madhe, sidomos në procesin e të mësuarit, merr motivimi i brendshëm. Motivimi i brendshëm është përcaktuar si motivimi për tu përfshirë në një aktivitet me qëllimin kryesor për të arritur kënaqësi të qenësishme (Ryan & Deci, 1997). Kështu, disa kërkues parashtrojnë se nëse studenti i nënshtrohet aktiviteteve të të mësuarit ku ai ka njëfarë kontrolli mbi arritjet e tij akademike kjo mund të çojë në rritjen e motivimit të tij të brendshëm (Pintrich & Schunk, 2009). Gjithashtu, autorë të tjerë kanë identifikuar se karakteristikat kryesore të cilat promovojnë motivimin për të mësuar janë sfidat, kuriziteti, kontrolli dhe fantazia

=====

(Lepper & Hodell, 1994). Disa kërkues të tjerë përcaktojnë se studentët të cilët kanë një motivim të brendshëm për të mësuar janë më të angazhuar. Sipas Guthrie, këta studentë kanë një angazhim më të madh se studentët e tjerë sepse ata bashkojnë cilësi të shumta, të cilat kanë si qëllim kryesor arritjen e qëllimit, natyrën kërkuese për të kuptuar, besimin në aftësitë individuale dhe marrjen e përgjegjësisë për të nxënë (Guthrie, 2010). Përsëri, i njëjti autor, vazhdon në arsyetimin se motivimi i brendshëm është shumë fitimprurës në promovimin e të nxënit dhe arritjeve sesa motivimi i jashtëm (Ryan & Deci, 1997).

Motivimi i studentëve është vërtetuar të jetë ndikues në procesin e të nxënit tek studentët gjithashtu (Helme, Clarke, 2001). Mirëpo, sipas hulumtimeve të ndryshme shkencore, ekzistojnë faktorë të ndryshëm të cilët influencojnë zhvillimin kognitiv dhe procesin e të mësuarit. Biggs (1987) grupon këta faktorë në faktorët e ndërlidhur me studentët; faktorët e ndërlidhur me metodat e mësimdhënies; dhe faktorët e ndërlidhur me sistemin si tërësi. Ndërsa, (Helme & Clarke, 2001), i ndërlidhin faktorët të cilët kanë ndikim në angazhimin kognitiv të studentëve me individin; ambientin ku zhvillohet të nxënit; dhe obligimet për të mësuar. McKeachie (1999) veçon se kur studentët janë të motivuar përgjatë studimeve, kur ata përfundojnë universitetin, notat dhe vlerësimet zëvendësohen me qëllime afatgjatë të tyre, dhe studentët kështu janë të shtyrë të vazhdojnë sukseset pavarësisht se si do të shpërblehen për ato. Davis (1999) gjithashtu potencon se studentët reagojnë pozitivisht, dhe janë të motivuar në klasë, atëherë kur lënda është e organizuar mirë, mësimdhënësi transmeton tek studentët entuziasmin për punë dhe material adekuat për lëndën, si dhe atëherë kur mësimdhënësi është në gjendje të tregojë ndjeshmërinë e tij në raport me studentët dhe aftësitë individuale të të nxënit që ata kanë. Prandaj, sipas këtij këndvështrimi, mësimdhënësit duhet të jenë në gjendje që të demonstrojnë qëllimet e tyre në raport me motivimin e studentëve, gjithashtu, meqë në këtë mënyrë studentët do të sfidohen dhe ndjehen sikur po e drejtojnë energjinë e tyre pozitive drejt arritjeve pozitive. Motivimi i studentëve është një element thelbësor që është e nevojshme për arsim cilësor. Si mund ta dimë kur nxënësit janë të motivuar? Ata i kushtoj vëmendje, ata fillojnë duke punuar në detyra menjëherë, ata bëjnë pyetje dhe përgjigje vullnetare, dhe ata duket të jenë të lumtur dhe të etur për mësim (Palmer, 2007). Në thelb, shumë pak, mund të ndodhë nëse nxënësit janë të motivuar në një bazë të qëndrueshme. Pesë përbërësit kryesorë që ndikojnë në motivimin e nxënësve janë: studenti, mësuesi, përmbajtja, metoda / procesi, dhe mjedisi. Për shembull, studenti duhet të ketë qasje, aftësinë, interesin, dhe vlerën e edukimit. Profesorët duhet të jetë të trajnuar mirë, duhet të përqendrohen dhe të monitorojnë procesin arsimor, të dedikuar dhe të përgjegjshëm për studentët e tij. Përmbajtja e temës duhet të jetë e qartë, inovative, nxitëse dhe e domosdoshme për nevojat e tanishme dhe të ardhshme të studentit. Metoda e

=====

punës apo procesi duhet të jetë krijues, inkurajues, interesantë, i dobishëm, dhe të sigurojë mjetet që mund të aplikohen në jetën reale të studentit. Mjedi duhet të jenë i arritshëm, i sigurt, pozitiv, i personalizuar sa më shumë të jetë i mundur, dhe i fuqishëm. Motivimi është i optimizuar kur studentët ballafaqohen me një numër të madh të këtyre përvojave motivuese. Studentët apo nxënësit në mënyrë ideale duhet të kenë shumë burime të motivimit në përvojën e tyre të të mësuarit në çdo klasë. (Palmer, 2007; Debnath 2005, D'Souza & Maheshwari, 2010).

8. Arsimi i lartë në Republikën e Kosovës

Republika e Kosovës ka popullatën më të re në Evropë dhe e sheh kapitalin njerëzor si pasurinë më të rëndësishme e cila do të përkrahë zhvillimin e ardhshëm të Kosovës. Arsimi i lartë po kalon nëpër një fazë të rritjes intensive të numrit të studentëve, mirëpo alokimet buxhetore, investimet dhe numri i personelit akademik nuk po i përcjellin ritmet e zhvillimit. Arsimi i lartë në Kosovë përfshin institucionet publike e private të arsimit të lartë. Edhe pse Kosova zyrtarisht nuk është pjesë e Procesit të Bolonjës, të gjitha institucionet e arsimit të lartë (me përjashtim të Universitetit Amerikan të Kosovës), i respektojnë udhëzimet e Bolonjës. Agjencia e Akreditimit e Kosovës udhëheq procesin e akreditimit për të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Sistemi i arsimit të lartë funksionon në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë të miratuar në vitin 2002, i cili aktualisht është duke u rishikuar dhe në bazë të Strategjisë për Arsimin e Lartë me pikat e referimit të vendosura për periudhën (PSAK,2005-2015) .

9. Historiku i Fakultetit MTHM

Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit (FMTHM) do të jetë si pasardhës i departamentit Menaxhment Turizëm dhe Hotelieri (1969-1975) që ka qenë në kuadër të Shkollës së Lartë Ekonomike, shkollë kjo e themeluar në vitin 1960 si institucion i arsimit të lartë dy vjeçar. Gjatë kësaj periudhe kanë studiuar dhe janë diplomuar student nga nacionalitete dhe besime të ndryshme si shqiptar, boshnjak, serb, rom, kroat, etj. Në vitin akademik 2001/2002 Shkolla e Lartë Ekonomike u reformua sipas modelit të Deklaratës së Bolonjës dhe po në këtë vit Senati i Universitetit të Prishtinës miratoi planet mësimore sipas kësaj deklarate për nivelin bachelor. Kjo shkollë u riemërua në Shkolla e Biznesit dhe pastaj në Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit. Po në këtë periudhë 2001/2002 u rihap departamenti i Menaxhmentit në Turizëm dhe Hotelieri i cili vazhdon të funksionon sot si Fakultet në vete. FMTHM i Universitetit Publik “Haxhi Zeka” Pejë , me seli në Pejë, është bartës i studimeve themelore dhe të tjera të përcaktuara me Ligjin e

Shkollimit të Lartë dhe me Statut të UPP-së. Studimet e rregullta dhe ato me korrespondencë në FMTHM në Pejë organizohen për fitimin e përgatitjes akademike Bachelor i shkencës. Në bazë të Statutit të UPP-së, FMTHM ka të drejtën që të organizojë edhe studime për përgatitjen akademike Master i shkencës dhe në këtë kontekst FMTHM-ja është përgatitur për zhvillimin e programeve master në vitin akademik 2013-2014. FMTHM-ja udhëhiqet nga Dekani si organi më i lartë udhëheqës. Këshilli i Fakultetit kryesohet nga dekani dhe ka këtë përbërje: dekani, prodekani, sekretari i fakultetit, anëtarë nga mësimdhënësit, asistentë dhe studentë. Sekretari i fakultetit është udhëheqës i stafit administrativ. Siç e kemi cekur edhe më lartë se FMTHM-ja ka departamente dhe programe (programe për studime bachelor dhe master). Këto departamente udhëhiqen nga shefat e departamenteve.

Tabela 1. Pyetësi drejtuar studentëve tek “Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit ”

NR	Pytjet	Indikatorët	Frekuenca	Përqindja	Devijimi Standard	Varianca
1.	Gjinia	Mashkull	56	54.9	.500	.250
		Femër	46	45.1		
2.	Niveli i shkollimit	Bachelor	80	78.4	.413	.171
		Master	22	21.6		
3.	Faktori përcaktues në zgjedhjen e këtij Institucionit të Arsimit të lartë shtetëror	Emri i mirë i institucionit	16	15.7	1.558	2.430
		Kosto më e ulët për studime	27	26.5		
		Lehtësia për t'u pranuar	12	11.8		
		I vetmi institucion që ofron studime në fushën e turizmit	25	24.5		
		Stafi akademik i përgaditur	13	12.7		
		Mundësia e marrjes së një burse	9	8.8		
4.	A janë përmbushur pritshmëritë tuaja për këtë institucion dhe program studimi	Po	89	87.3	.335	.112
		Jo	13	12.7		

5.	A mendoni se me anë të këtij drejtimi merrni/fitoni njohuri shkencore , aftësi të mira praktike në fushen e turizmit, hoteleris dhe mjedisit.	Po	91	89.2	.546	.299
		Jo	7	6.9		
		Pjesërisht	2	2		
		Nuk e di	2	2		
6.	A mendoni se është e arsyeshme/drejtë shpërndarja e lëndëve gjatë vitit akademik	Po	86	84.3	.365	.134
		Jo	16	15.7		
7.	A planifikon programi eksperiencia praktike	Po	92	90.2	.298	.089
		Jo	10	9.8		
	Organizimi dhe format mësimdhënies	Aspak i kënaqur	0	0	.355	.127
		Jo i kënaqur	0	0		
		Deri dikund i kënaqur	0	0		
		I kënaqur	15	14.7		
		Shumë i kënaqur	87	85.3		
8.	Cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve	Aspak i kënaqur	0	0	.740	.548
		Jo i kënaqur	0	0		
		Deri dikund i kënaqur	22	21.6		
		I kënaqur	45	44.1		
		Shumë i kënaqur	35	34.3		
	Cilësinë e sallave të bibliotekës dhe me sasinë e titujve	Aspak i kënaqur	0	0	.868	.755
		Jo i kënaqur	0	0		
		Deri dikund i kënaqur	34	33.3		
		I kënaqur	25	24.5		
		Shumë i kënaqur	43	42.2		
9.	A pajtoheni dhe si i vlerësoni rastet e studimit dhe	Aspak nuk pajtohem	0	0	.808	.654
		Pajtohem deri diku	0	0		

=====						
	shembujt e sjella nga pedagogu	Neutral	27	26.5		
		Pajtohem	34	33.3		
		Plotësisht pajtohem	41	40.2		
10.	A stimulojnë pedagogët interaktivitetin dhe debatin gjatë zhvillimit të procesit mësimor	Po	77	75.5	.686	.471
		Jo	13	12.7		
		Pjesërisht	12	11.8		
11.	A pajtoheni ju më nivelin e plotësimit të nevojave tuaja me materiale të domosdoshëm për mësimin (tekste bazë, literaturë shtesë të huaj ose vendase, etj.)	Aspak nuk pajtohem	11	10.8	1.363	1.860
		Pajtohem deri diku	13	12.7		
		Neutral	6	5.9		
		Pajtohem	34	33.3		
		Plotësisht pajtohem	38	37.3		
12.	Çfarë mendoni për format/metodat aktuale të kontrollit të njohurive tuaja	Format e kontrollit që përdoren janë të përshtatshme	78	76.5	.426	.182
		Format e kontrollit që përdoren nuk janë të përshtatshme	24	23.5		
13.	A tregohen të drejtë/objektive pedagogët në vlerësimin tuaj	Po	57	55.9	.498	.249
		Jo	45	44.1		
14.	A ju kthehen në kohë testimet me shkrim dhe të plotësuara me komente që ju	Po	68	66.7	.473	.224
		Jo	34	33.3		
15.	Si i vlerësoni zyrat administrative të institucionit	Me ndihmojnë shumë	75	73.5	.443	.197
		Nuk më ndihmojnë shumë	27	26.5		
16.	A e shfrytëzoni bibliotekën e	Aspak	6	5.9	.888	.790
		Pak	13	12.7		

=====			
institucionit si një	Mesatarisht	35	34.3
burim të rëndësishëm			
informacioni	Shumë	48	47.1

10. Rezultatet e pyetësorit

Përgjigjet e dhëna në pyetjet e bëra nëpërmes pyetësorit janë paraqitur në tabelën e mësipërme. Siç mund të shihet në tabelë , ka pasur një numër të përafërt të të anketuarve që studiojnë në Universitetin "Haxhi Zeka" - Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit, ku të anketuar kanë qenë 46 student të gjinisë femërore ose 45.1% e tyre nga numri i gjithëmbarshtëm dhe 56 ose 54.9 % student të anketuar të gjinisë mashkullore. Niveli i tyre i studime në bachelor është 80 të anketuar ose 78.4% e tyre ,ndërsa në nivel master janë të anketuar 22 student ose 21.6% e tyre nga numri i gjithëmbarshtëm. Tek pyetja e tretë e pyetësorit: Faktori përcaktues në zgjedhjen e këtij Institucionit të Arsimit të lartë shtetëror, 16 ose 15.7% të anketuar janë përgjigjur se institucioni ka emër të mirë, 22 ose 26.5% të anketuar janë përgjigjur se Kostoja e studimeve është e ulët , 12 ose 11.8 % e të anketuar janë përgjigjur se lehtë është për t'u pranuar, 25 ose 24.5 % e të anketuar janë përgjigjur ky është i vetmi institucion që ofron studime në fushën e turizmit, 13 ose 12.7% e të anketuarve janë përgjigjur se stafi akademik është i përgatitur, 9 ose 8.8% e të anketuarve janë përgjigjur për mundësin e marrjes së një burse. Tek pyetja e katërt e pyetësorit: A janë përmbushur pritshmërinë tuaja për këtë institucion dhe program studimi, të anketuar janë përgjigjur më PO 89ose 87.3% e tyre, ndërsa më JO 13 ose 12.7% e numrit të gjithëmbarshtëm të të anketuarve. Tek pyetja e pestë e pyetësorit: A mendoni se me anë të këtij drejtimi merrni/fitoni njohuri shkencore, aftësi të mira praktike në fushën e turizmit, hotelerisë dhe mjedisit, 91 ose 89.2% e të anketuarve janë përgjigjur me PO, ndërsa 7ose 6.9 % e të anketuarve janë përgjigjur më JO, 2ose 2% janë përgjigjur Pjesërisht dhe 2ose 2% e të anketuarve janë përgjigjur më Nuk e Di. Tek pyetja e gjashtë e pyetësorit: A mendoni se është e arsyeshme/drejtë shpërndarja e lëndëve gjatë vitit akademik, 86 ose 84.3 % e të anketuarve janë përgjigjur me PO, ndërsa16ose 15.7% % e të anketuarve janë përgjigjur më JO. Tek pyetja e shtatë e pyetësorit: A planifikon programi eksperiencia praktike, 92 ose 90.2% e të anketuarve janë përgjigjur me PO, ndërsa 10ose 9.8% e të anketuarve janë përgjigjur më JO. Tek pyetja e tetë e pyetësorit:Sa janë të kënaqur studentët më organizimin dhe format e mësimdhënies: Shumë i kënaqur janë përgjigjur 35 ose 34.3% e të anketuarve, të kënaqur janë përgjigjur 45 ose 44.1% e të anketuarve ndërsa Deri diku i kënaqur janë përgjigjur 22 ose 21.6% ndërsa Aspak i kënaqur dhe Jo i kënaqur nuk kemi pasur përgjigje. Tek pyetja : lidhur me cilësinë e sallave dhe sasinë e titujve të bibliotekës kemi përgjigje nga të anketuarit, Shumë i kënaqur janë ,43 ose 42.2% e të anketuarve, të kënaqur 25 ose

=====

24.5% e të anketuarave, Deri diku të kënaqur janë 34 ose 33.3% e të anketuarave ndërsa Aspak i kënaqur dhe Jo i kënaqur nuk kemi pasur përgjigje. Tek pyetja e nëntë e pyetësorit: A pajtoheni dhe si i vlerësoni rastet e studimit dhe shembujt e sjella nga pedagogu , Plotësisht pajtohem janë përgjigjur 41 ose 40.2% e të anketuarave, Pajtohem janë përgjigjur 34 ose 33.3% e të anketuarave, Neutral janë përgjigjur 27 ose 26.5% e të anketuarave ndërsa Aspak nuk pajtohem dhe Pajtohem deri diku nuk kemi pasur përgjigje. Tek pyetja e dhjetë e pyetësorit: A stimulojnë pedagogët interaktivitetin dhe debatin gjatë zhvillimit të procesit mësimor, 77ose 75.5% e të anketuarave janë përgjigjur me PO, ndërsa 13 ose 12.7% e të anketuarave janë përgjigjur më JO, Pjesërisht janë përgjigjur 12ose 11.8% e të anketuarave. Tek pyetja e njëmbëdhjetë e pyetësorit: A pajtoheni ju më nivelin e plotësimit të nevojave tuaja me materiale të domosdoshëm për mësimin (tekste bazë, literaturë shtesë të huaj ose vendase, etj.) kemi përgjigje: Plotësisht pajtohem janë përgjigjur 38 ose 37.3 % e të anketuarave, Pajtohem janë përgjigjur 34 ose 33.3% e të anketuarave, Neutral janë përgjigjur 6 ose 5.9 % e të anketuarave, Pajtohem deri diku janë përgjigjur 13 ose 12.7 % e të anketuarave, Aspak nuk pajtohem janë përgjigjur 11 ose 10.8% e të anketuarave. Tek pyetja e dymbëdhjetë e pyetësorit: Çfarë mendoni për format/metodat aktuale të kontrollit të njohurive tuaja, Format e kontrollit që përdoren janë të përshtatshme janë përgjigjur 78 ose 76.5% e të anketuarave ndërsa Format e kontrollit që përdoren nuk janë të përshtatshme janë përgjigjur 24 ose 23.5% e të anketuarave. Tek pyetja e trembëdhjetë e pyetësorit: A tregohen të drejtë/objektivë pedagogët në vlerësimin tuaj, 57ose 55.9% e të anketuarave janë përgjigjur me PO, ndërsa 45 ose 44.1 % e të anketuarave janë përgjigjur më JO. Tek pyetja e katërbëdhjetë e pyetësorit: A ju kthehen në kohë testimet me shkrim dhe të plotësuar dhe me komente, 68 ose 66.7 % e të anketuarave janë përgjigjur me PO, ndërsa 34 ose 33.3 % e të anketuarave janë përgjigjur më JO. Tek pyetja e pesëmbëdhjetë e pyetësorit: Si i vlerësoni zyrat administrative të institucionit, Me ndihmojnë shumë janë përgjigjur 75 ose 73.5 % e të anketuarave, ndërsa Nuk më ndihmojnë shumë janë përgjigjur 27ose 26.5% e të anketuarave. Tek pyetja e gjashtëmbëdhjetë e pyetësorit: A e shfrytëzoni bibliotekën e institucionit si një burim të rëndësishëm informacioni, Shumë janë përgjigjur 48 ose 47.1% e të anketuarave, Mesatarisht janë përgjigjur 35 ose 34.3% e të anketuarave, Pak janë përgjigjur 13 ose 12.7% e të anketuarave dhe ose 5.9% të të anketuarave nuk e përdorin Aspak bibliotekën e institucionit.

11. Gjetjet nga të anketuarit

Duke u bazuar tek debatet akademike të autorëve të marr në studim (Helme, Clarke, 2001; Biggs,1987; Helme & Clarke ,2001; McKeachie 1999; Davis ,1999; Palmer, 2007; Debnath 2005, D'Souza & Maheshwari, 2010) dhe duke u mbështet në

=====

gjetjet nga të anketuarit vijnë në përfundim se studentët e anketuar janë të motivuar apo të kënaqur më studimet e tyre në “Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit” ku me një përqindje më të madhe janë përgjigjur pozitivisht në pyetjet: studimi i tyre ka kosto të ulët, është i vetmi institucion që ofron studime në fushën e turizmit, ju pëlqen programi i studimeve, mendojnë se me anë të këtij drejtimi fitojnë njohuri shkencore, aftësi të mira praktike në fushën e turizmit, hotelierisë dhe mjedisit, janë shumë të kënaqur më Organizimi dhe format e mësimdhënies, me stimulimin e pedagogëve në interaktivitetin dhe debatin gjatë zhvillimit të procesit mësimor, janë të kënaqur me punën e zyrave administrative të institucionit etj. Në bazë të përgjigjeve të të anketuarave kemi ardhur në vërtetim të hipotezës së ngritur në studim.

Pyetja kërkimore:

A janë studentët e motivuar dhe të kënaqur për studimet e tyre në fushën e turizmit dhe të hotelierisë?

Hipoteza:

“Studentët janë të motivuar dhe të kënaqur për studimet e tyre në fushën e turizmit dhe të hotelierisë”

12. Rekomandim

Megjithatë, përkundër efektit të kushteve jo të favorshme të punësimit në përgjithësi, gatishmëria e të anketuarve për të studiuar në studime pas diplomike në turizmin dhe hotelieri është shumë e madhe, dhe angazhimi i tyre për të punuar në këtë drejtim pas diplomimit është shumë i madh. Një nga arsytet për imazhin negativ në industrisë se turizmit dhe hotelierisë është:

Duhet të punësojnë më tepër staf të cilët kanë arsimim adekuat në fushën e turizmit dhe të hotelierisë.

Duhet ta kenë të qartë menaxherët ose ndërmarrësit e bizneseve hoteliere se Burimet njerëzore të arsimuar me cilësi të lartë profesionale do të ndihmojnë për të përmirësuar cilësinë e përvojës së punës dhe përmirësimin e imazhit të kësaj industrisë.

Duhet përmirësuar kushtet e përgjithshme të punësimit në këtë industri në një periudhë kohore afat shkurtë, duke ju mundësuar studenteve të sotëm, me kualifikimet adekuate, për t'u bërë menaxherë efektivë për të nesërmen.

Prandaj, kjo mund të pretendohet se një nga mënyrat e rritjes së peshës së drejtpërdrejtë në punësim në turizëm dhe hotelieri është që të rrisë ofertën e fuqisë punëtore të mirë-arsimuar.

Referencat

- Aslanian, C. B., & Brickell, H. M. (1980). Americans in transition: Life changes as reasons for adult learning. New York: College Entrance Examination Board.
- Biggs, J.B., (1987). Student Approaches to Learning and Studying. Victoria: Australian
- Cross, 1991). Ne Beverly J. , V., Cross, W. & Worrell, F. (2002). Validating the Cross
- Cross, K.P. (1981). Adults as learners: Increasing participation and facilitating learning. San Francisco: Jossey-Bass.
- D'Souza, K. A. and Maheshwari, S. K. (2010). Factors Influencing Student Performance in the Introductory Management Science Course. Academy of Educational Leadership Journal, 14(3), 99-120.
- Davis, A.J., (1999). Prescribing Teaching Methods. Journal of Philosophy of Education
- Debnath, S. C. (2005). College Student Motivation: An Interdisciplinary Approach to an Integrated Learning Systems Model. Journal of Behavioral and Applied Management, 6(3), 168-189.
- education. Adult Education Quarterly, 44(2), 64-82.
- Guthrie, J.T. Context for engagement and motivation in reading. 2003.
- Heelan, C.M. (2001, February/March). Working toward a global view. Community College Journal. Available from <http://www.communitycollegejournal.com>.
- Helme, S., & Clarke, D. (2001). Identifying cognitive engagement in mathematics
- Henry, G., & Basile, K. (1994). Understanding the decision to participate in formal adult
- Hoti, A. dhe Adnett, N. (2004) Schooling in a High Unemployment Economy: The case of Kosova; Staffordshire University Business School, Economics Division, Working Paper Nr. 2004.01.
- Keller, J.M. Instructional –design theories and models: An overview of their current status. (Mahwah: Lawrence Erlbaum Associates. 1983)
- Knowles, M. (1990). The adult learner: A neglected species. Houston, TX: Gulf
- Lepper, M.R., & Hodell, M. "Intrinsic motivation in the classroom". Research on motivation in Edcation. San Diego, CA: Academic Press. 1994
- Malcolm Shepherd Knowles (1913 – 1997). Ne, Smith K, (2002). Malcolm Knowles,
- McKeachie, J. Wilbert. (1999). Teaching Tips: Strategies, Research and Theory for
- Palmer, D. (2007). What Is the Best Way to Motivate Students in Science? Teaching Science-The Journal of the Australian Science Teachers Association, 53(1), 38-42.
- Pintrich, P.R., & Schunk, D.H. Motivation in education: Theory, research, and applications. (Upper Saddle River, NJ: Merrill Prentice Hall. 1996)
- Pintrich, P.R., & Schunk, D.H. Motivation in education: Theory, research, and applications. Pg, 43.
- Plani strategjik i arsimit në Kosovë, 2011-2016.

- =====
- Racial Identity Scale. Journal of Counseling Psychology. ol. 49, No. 1, 71–85.
 - Ryan, R., &Deci, E.L. Intrinsic and extrinsic motivations: Classic definitions and new directions,Pg, 31. 33(3): 387-401.
 - Song, J.H. “Research issues of motivation in web-based instruction”. Quarterly Review of Distance Education. 2000. Vol 1, Nr 3, p. 225-229